

## PROVO PRODUKTET DHE FITO SHPERBLIMET

### Neni 1

#### ORGANIZATORI I LOJËS SHPËRBLYESE

1. Organizatori i Lojës Shpërblyese “Provo produktet dhe fito shperblimet”: “ALCEDRIX” sh.p. k (referuar këtu më poshtë si “Alcedrix”), person juridik, regjistruar me numrin unik identifikues NUI: 810857146 me seli në adresën: Rr. Afrim Zhitija nr. 43, 10000 Prishtinë, Kosovë, rregullisht i përfaqësuar në këtë rregullore. Alcedrix është i regjistruar si subjekt tatimpagues në Administratën Tatimore të Kosovës.
2. Me anë të kësaj Loje Shpërblyese Alcedrix ka për qëllim të promovojë kampanjën e produkteve në të gjithë rrjetin e barnatoreve dhe kozmetikave që marrin pjesë për të gjithë klientët në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

### Neni 2

#### AFATI

1. Loja Shpërblyese do të zhvillohet brenda periudhës kohore 15 Qershor deri me 30 Shtator.
2. Ne javët pasuese, pas perfundimit të periudhës së lojës shpërblyese, do të behet tërheqja e shorteut për fituesit e lojës shpërblyese. Data e mbajtjes së shorteut final do të përcaktohet në një njoftim të veçant për të gjithë klientët.

### Neni 3

#### MEKANIZMI I LOJËS SHPËRBLYESE

Alcedrix ka ndarë dy linja produktesh nga portfolio e saj në të gjithë rrjetin e dyqaneve partnere dhe klientët mund të blejnë produkte nga këto brende dy brende pjesëmarrëse.

Klientët e Alcedrix që dëshirojnë të marrin pjesë në këtë Lojë Shpërblyese duhet të ndjekin hapat e mëposhtme:

1. Së pari, të bëjnë të paktën një blerje të njërit nga produktet pjesëmarrëse Absolute Dry apo Okeffee’s në njërin nga dyqanet partnere (barnatore/kozmetike)
2. Klientët që dëshirojnë të marrin pjesë në këtë Lojë Shpërblyese duhet të kenë kuponin fiskal i cili përmban numrin e kuponit tatimor, i cili gjenerohet automatikisht pasi Klienti ka kryer blerje të produkteve tona pjesëmarrëse.
3. Në kupon fiskal duhet të shënohet Emri dhe Mbiemri si dhe numri kontaktues i klientit që dëshiron të marr pjesë në lojën shpërblyese.
4. Pas shënimit të kontakteve të klientit, kuponi fiskal duhet të vendoset brenda kutisë së posaçme e cila do të hapet vetëm në ditën e tërheqjes së shorteut.
5. Do të konsiderohen pjesëmarrës në shorte, të gjithë ata klientë të cilët kanë blerë produktin Absolute Dry apo Okeffe’s brenda periudhës 15 Qershor - 30 Shtator 2024.

6. Në momentin që mbyllet Loja Shpërblyese, automatikisht do të bëhet grumbulimi i të gjithë kutive në pikat partnere dhe do të vendosen në një vend të sigurt.

7. Tërheqja e shorteut do të organizohet live në mënyrë transparente përmes transmetimit livestream në rrjetet tona sociale.

8. Fituesi për të tërhequr dhuratën, duhet të paraqitet në zyrën qendrore të Alcedrix. Në ditën e paraqitjes duhet të jetë i pajisur me mjet identifikimi dhe me numrin celular fitues.

Neni 4

#### PJESËMARRJA

Pjesëmarrës në këtë Lojë Shpërblyese kanë të drejtë të jenë:

1. Të gjithë klientët e Alcedrix të cilët kryejnë blerje të produkteve tona pjesëmarrëse në dyqanet partnere (barnatore/kozmetike)
2. Kuponi fiskal për lojën shpërblyese duhet të ketë numrin e kuponit tatimor
3. Kuponat fiskal konsiderohen të vlefshëm brenda periudhës kohore për të cilin hidhet shorteu 15 Qershor deri me 30 Shtator 2024.
4. Kuponat fiskal që nuk e kanë të shkuar numrin e kuponit tatimor se bashku me shënimet e kontaktit të klientit do të përjashtohen nga loja shpërblyese.
5. Të gjithë pjesëmarrësit kanë mundësinë të kontrollojnë fituesit në web faqen e Alcedrix dhe rrjetet tona sociale ku do të publikohet kjo rregullore dhe informacioni i përditësuar.
6. Të gjithë pjesëmarrësit kanë mundësinë të marrin informacion në çdo dyqan partner si edhe në email adresën [info@alcedrix.com](mailto:info@alcedrix.com).
7. Pjesëmarrësit në Lojën Shpërblyese duhet të jenë 18 vjeç e sipër. Nëse numri i përzgjedhur është në përdorim të një të mituri (nën 18 vjeç) atëherë shpërblyesja do të tërhiqet prej prindit/kujdestarit ligjor, me verifikim me letërnjoftim. Alcedrix nuk do të promovojë pjesëmarrjen e personave të mitur.

Neni 5

#### TERRITORI

Loja shpërblyese “Provo produktet dhe fito shpërblyesjet” do të zhvillohet në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 6

#### ÇMIMET

Në përfundim të lojës shpërblyese, në datën e hedhjes së shortit final, i cili do të komunikohet me të gjitha format e komunikimit Klientit, do të shpallen në total 50 fitues të cilët do të kenë mundësinë të përfitojnë një nga çmimet si mëposhtë:

1. Lista e dhuratave

Nr. Shortit	Nr	Çmimi	Fitues
<b>Shorti 1-rë</b>	1	2(dy) iPhone 15	2
	2	1(një) Sony PlayStation	1
	3	1(një) Trotinet Segëay ninebot	1
	4	3(tre) Rrobalarese Beko	3
	5	3(tre) Tablet Samsung	3
	6	3(tre) TV LG 55inch	3
	7	3(tre) SoundBar Sony	3
	8	3(tre) Fritez Philips	3
	9	3(tre) Aparat kafe Beko	3
	10	3(tre) Fshese robotike xianomi	3
	11	3(tre) Fshese elektrike Beko	3
	12	3(tre) Hekur me avull Philips	3
	13	3(tre) Philips Juicer	3
	14	3(tre) Tharese per floke	3
	15	5 (pesë) Kufje JBL	5
	16	5 (pesë) Kufje JBL	5
	17	3 (tre) Udhëtime në çift (në një nga destinacione sipas preferencave: Paris, Barcelone ose Rome)	3
<b>Shorti 2-të</b>	1	5 (pesë) Udhëtime në çift (në një nga destinacione sipas preferencave: Paris, Barcelone ose Rome)	5

2. Fituesit do të zgjidhen për secilin çmim në bazë të renditjes rastësore duke u tërhequr kuponi fiskal në mënyrë manuale pa shikuar tek kutija e të gjithë kuponëve.
3. Në total Alcedrix do të dhurojë 50 dhurata përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Loje Shpërblyese.
4. Çmimet e Lojës Shpërblyese janë të patransferueshme pavarësisht çdo rrethane apo situatë.
5. Çmimet nuk mund të këmbehen apo të zëvendësohen me asnjë gjë tjetër.
6. Alcedrix mund të refuzojë dhënien e cmimit/cmimeve në rast se ajo konstaton se nuk janë respektuar kushtet e kësaj Rregulloreje, apo në rast se fituesit rezultojnë të tillë si rezultat i ndonjë parregullesie apo mashtrimi.

## Neni 7

### NJOFTIMI I FITUESVE DHE TËRHEQJA E ÇMIMIT

1. Brenda 2 ditëve pune nga gjenerimi i fituesve nga hedhja e shorteut, numrat e telefonit fitues do të lajmërohen me anë të SMS dhe ku do të informohen që janë fitues të Lojës Shpërblyese “Provo produktet dhe fito shperblimet”. Fituesit do të kontaktohen edhe me telefon nga kompania Alcedrix ku do të kërkohen edhe detajet identifikuese. Fituesi do të kontaktohet te pakten tre (3) here me telefon dhe ne rast se nuk pergjigjet do te procedohet me nje numer tjeter fitues si zevendesues.
2. Për të tërhequr çmimin, fituesit duhet të paraqiten në zyrat qendrore të Alcedrix me adresë: Rruga Afrim Zhitija nr. 43, 10000 Prishtinë, Kosovë. Në momentin e paraqitjes për tërheqjen e cmimit, fituesit do t’ju kërkohet të japin të dhënat e tyre dhe shoqëruesit të cilat janë: Emër, Mbiemër, Datëlindje, kopjen e kartës së identitetit dhe/ose i pasaportës si dhe adresa e banimit. Fituesi duhet të ketë me vete edhe numrin e telefonit me të cilin është kontaktuar për t’u njoftuar se ka fituar.
3. Nëse fituesi nuk paraqitet për të tërhequr cmimin brenda dy (2) ditëve nga momenti i njoftimit, Alcedrix do të kontaktojë fituesin nëpërmjet telefonit për ti rikujtuar cmimin që ka fituar nga Loja Shpërblyese. Nëse fituesi nuk paraqitet ditën e njoftimit apo nuk pergjigjet do te procedohet me nje numer tjeter fitues si zevendesues.

## Neni 8

### TË DHËNAT E PJESËMARRËSVE

1. Cdo pjesëmarrës në këtë Lojë Shpërblyese pranon shprehimisht se Alcedrix mund të përpunojë të dhënat e tyre personale, të kërkuara sipas kësaj Rregulloreje, për qëllime të kësaj Loje Shpërblyese dhe për çdo qëllim tjetër të ligjshëm të Alcedrix në përputhje me parashikimet e ligjit LIGJIN NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE. Të gjitha të dhënat personale lidhur me fituesit dhe të dhënat për mënyrën e organizimit të Lojës Shpërblyese do të ruhen deri në mbarimin e lojës shpërblyese, Tetor 2024.

## Neni 9

### TAKSA DHE TATIMET

Fituesi nuk do të jetë subjekt detyrimesh, tarifash apo garancish që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me dhuratën përveç atyre të cilat mund të kerkohen detyrimisht për fituesin nga legjislacioni në fuqi në Republikën në Kosovë. Nëse me legjislacionin në fuqi në kohën kur dorëzohet dhurata kërkohet që organizuesi i lojës të mban në burim ndonjë lloj të tatimit, atëherë organizuesi i lojës do të mbajë tatimin në burim për llogari të Fituesit.

## Neni 10

### PUBLICITETI

Komunikimi i Lojës Shpërblyese do të bëhet nëpërmjet kanaleve të komunikimit që Alcedrix ka në dispozicion si WEB faqen zyrtare, radio, media dixhitale, print dhe komunikim në dyqane partnere.

Me pranimin e paktes së lojës shpërblyese, fituesit kanë dhënë miratimin që emri dhe imazhi i tyre mund të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Alcedrix dhe në faqet zyrtare që Alcedrix ka në rrjetet

sociale si Facebook, Instagram dhe Tik tok. Gjithashtu fituesit, i jep të drejta të plota Alcedrix lidhur më përdorimin e të drejtave të imazhit të tyre në fotografitë, videot (ose cdo version të tyre që ka prezencën e tyre) të cilat do të shfaqen në publik në kuadrin e fushatave promovionale aktuale apo të ardhshme të Alcedrix sh.p.k.

Neni 11

#### FORCA MADHORE

Loja Shpërblyese mund të ndërpritet vetëm në rastin e rrethanave për të cilat Alcedrix nuk është përgjegjëse, dmth., që nuk mund parandalohen, riparohen apo shmangen dhe në rast të ndonjë urdhërimit sipas ligjeve në fuqi nga autoritetet shtetërore. Njoftimi për ndërprerjen edhe çdo njoftim tjetër i rëndësishëm në lidhje me Lojën Shpërblyese, do të publikohet në web faqen [www.alcedrix.com](http://www.alcedrix.com) dhe në rrjetet sociale Facebook edhe Instagram.

Neni 12

#### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Me pjesëmarrjen në këtë Lojë Shpërblyese klientët e Alcedrix kanë dhënë miratimin e tyre duke pranuar automatikisht rregullat dhe mekanizmin e Lojës Shpërblyese. Në rast të kërkesave të klientëve për të mos u përfshirë në këtë Lojë Shpërblyese, Alcedrix sh.p. k nuk do t'i përfshijë ata në shorteun që do të hidhet për shpalljen e fituesve. Në rast mosmarreshjesh, organi kompetent për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Themelore Prishtinë.

Neni 13

#### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Rregullorja e Lojes Shpërblyese është e publikuar në faqen e internetit të Alcedrix, [www.alcedrix.com](http://www.alcedrix.com). Informacioni mbi Lojën Shpërblyese mund të merret gjithashtu përmes rrjeteve tona sociale.
2. Me pjesëmarrjen tuaj në lojën shpërblyese, ju konsideroheni që keni lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Rregulloreje dhe në veçanti rregullat e lojës dhe politikën e privatësisë, dhe jeni pajtuar me përmbajtjen e kësaj Rregulloreje dhe Politikën e Privatësisë dhe nuk ka nevojë për nënshkrimin tuaj mbi këtë Rregullore dhe Politikën e Privatësisë.

#### POLITIKA E PRIVATËSISË

##### Mbrojtja e të dhënave personale

Të dhënat personale të mbledhura, do të përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale janë çështje të një rëndësie të veçantë dhe Alcedrix është i përkushtuar të zbatojë rigorozisht të gjithë kuadrin ligjor në mbrojtje dhe respektim të tyre, veçanërisht LIGJIN NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE (me të gjitha plotësimet dhe ndryshimet që mund të ndodhin kohë pas kohe) si dhe aktet nënligjore përkatëse.

2. Të dhënat personale të cilët i mbledh dhe i përpunon Alcedrix SHPK

- Emri dhe mbiemri, data e lindjes, vendi i lindjes, gjinia, statusi, të dhënat e kontaktit (numri i telefonit, e-mail, adresën e banimit), arsimimin, dokumentet që vërtetojnë identitetin tuaj, imazhi juaj në rast të fitimit të dhuratës.

Në rast se na kontaktoni, ne mund të mbajmë regjistrim të komunikimit.

### 3. Baza ligjore dhe qëllimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale bëhet për këtë qëllim:

Pjesëmarrja në Lojën Shpërblyese [“Provo produktet dhe fito shperblimet”]

Baza ligjore: Neni 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 i LIGJIT NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

### 4. A jeni të detyruar që të ndani të dhënat tuaja personale me Ne?

Nuk jeni të detyruar që të ndani me ne të dhënat tuaja personale, por në qoftë se nuk i kemi ato, është e pamundur që t’ju mundësojmë pjesëmarrjen në lojën shpërblyese.

### 5. Menaxhimi i pëlqimeve për përpunimin e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave tuaja personale bëhet vetëm në bazë të pëlqimit tuaj. Me vendosjen e kuponit fiskal ku ju vetë keni shënuar të dhënat tuaja, konsiderohet se ju keni dhënë pëlqimin për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave tuaja personale. Pavarësisht dhënies së pëlqimit, Ju keni të drejtë që në çdo kohë të bëni tërheqjen e pëlqimit për procesim të të dhënave tuaja personale. Tërheqjen e pëlqimit mund ta bëni duke na kontaktuar me e-mail në adresë: [info@alcedrix.com](mailto:info@alcedrix.com) ose përmes postës në adresë: Alcedrix SHPK, Rruga Afrim Zhitija nr. 43, 10000, Prishtinë, Kosovë.

Tërheqja e pëlqimit nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit e cila është bazuar në pëlqimin e dhënë para tërheqjes së tij.

Revokimi apo tërheqja e pëlqimit do të rezultojë me ndërprerje të menjëhershme të pjesëmarrjes suaj në lojën shpërblyese sepse pa të dhënat e juaja personale nuk do të jemi në gjendje t’i përmbushim detyrimet tona kontraktuale ndaj jush që lidhen me lojën shpërblyese.

### 6. Afati i ruajtjes së të dhënave personale

Alcedrix ruan të dhënat tuaja personale deri në përfundimin e lojës shpërblyese, deri në fund të muajit Shtator 2024.

### 7. TË DREJTAT TUAJA

#### 7.1 E drejta për të përmirësuar të dhënat tuaja personale.

Nëse dëshmoni që të dhënat tuaja personale të cilat ne i posedojmë, nuk janë të sakta, ju mund të kërkonte që të dhënat e pasakta të përmirësohen, përmes adresës elektronike: [info@alcedrix.com](mailto:info@alcedrix.com)

#### 7.2 E drejta për të fshirë të dhënat personale.

Ju keni të drejtë të kërkonte që të kufizojmë përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe/ose fshirjen e të dhënave tuaja. Kërkesën për fshirjen e të dhënave të lidhura me ju, mund ta paraqitni në çdo moment

dhe Alcedrix do t'i fshijë ato të dhëna. Kërkesën për fshirje të dhënave personale mund ta kërkonti në adresën elektronike: [info@alcedrix.com](mailto:info@alcedrix.com)

### 7.3 E drejta e kundërshtimit

Nëse konsideroni që të drejtat tuaja janë shkelur, ju keni të drejtë për të paraqitur kundërshtim. Për të ushtruar të drejtat tuaja, dërgoni një e-mail në adresën elektronike në vijim: [info@alcedrix.com](mailto:info@alcedrix.com)

### 7.4 E drejta në ankesë

Ju keni të drejtë për të paraqitur ankesë në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

- Nëse mendoni se ato të dhëna nuk jemi duke i përpunuar në përputhje me pëlqimin tuaj
- Nëse përpunimi bëhet me ndihmë të procedurave të automatizuara.

### 7.5 E drejta për kufizimin e përpunimit:

Mund të kërkonti kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja:

- Nëse kundërshtoni saktësinë e të dhënave gjatë një periudhe që na lejon të verifikojmë saktësinë e këtyre të dhënave;
- Nëse përpunimi i të dhënave ka qenë e kundërligjshme, por refuzoni fshirjen dhe në vend të kësaj kërkonti kufizimin e përdorimit të të dhënave;

Nëse na drejtoheni përmes e-mail [info@alcedrix.com](mailto:info@alcedrix.com) për të ushtruar të drejtën tuaj, Alcedrix mund të kërkojë nga ju që të identifikoheni para se të vazhdojë me kërkesën tuaj.

## 8. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale në sistemin e Alcedrix

Alcedrix mbron të dhënat tuaja personale me teknologjinë më bashkëkohore të IT-së dhe me sisteme të mbrojtjes fizike. Të gjithë të punësuarit në Alcedrix veprojnë në përputhje me protokolet dhe procedurat e brendshme dhe me këtë Politikë me qëllim të ruajtjes së privatisë suaj dhe për të pamundësuar keqpërdorimin potencial të të dhënave.

## 9. Kontakti

Nëse keni pyetje në lidhje me këtë Deklaratë ose dëshironi informata shtesë në lidhje me mënyrën e mbrojtjes, apo dëshironi të kontaktoni personin përgjegjës të Alcedrix për mbrojtjen e të dhënave, ju lutemi që të na dërgoni një email në adresën: [info@alcedrix.com](mailto:info@alcedrix.com). Ne do të bëjmë përpjekjet maksimale që t'ju përgjigjemi brenda 5 ditëve të punës (përfshijë ditët e fundjavës).